



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2019:087282

Datë: 07.06.2019

Numri i dokumentit: 00347300

P.nr.168/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL Sipas gjyqtarit Qemail Suka, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional në lëndën penale kundër të pandehurit F. K. nga fshati K. Komuna Suharekë, me numër personal, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 pika 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.04/L-082 (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokuroria Themelore Prizren - Departamenti i përgjithshëm nr. PP/II. nr. 794-1/19 , të datës 15.05.2019 në seancën publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 03.06.2019, në praninë e Prokurorit të Shtetit Milot Krasniqi, të pandehurit F. K. dhe mbrojtësit të tij Av.S. H. nga Suhareka, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 07.06.2019 përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari F.K, nga i ati H.K dhe e ëma M.K e lindur K i lindur me 06.07.1983, nga fshati K.Komuna Suharekë, ku edhe tani jeton, me numër personal.....shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, baba i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i padënuar për ndonjë vepër penale.

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 29.03.2019, rreth orës 11:00 në fshatin K.Komuna Suharekë, saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët familjare, i shkakton lëndime të lehta trupore i cili rezulton në dëmtimin e përkohshëm të të dëmtuarës Sh.K pas një mosmarrëveshje të vazhdueshme familjare që kishte me të dëmtuarën – bashkëshorten e tij Sh.K, në atë mënyrë pas fjalosjes mes tyre, i akuzuari F.K e ndërmer veprimin e tij duke e kap për fyti dhe shtrënguar fort duke e mbajtur gjatë, të cilën më pastaj me forcë e hedhë në divane dhe si rezultat të kësaj të dëmtuarës Sh.K, i shkakton lëndime të lehta trupore, që paraqesin gërvishje prerëse në regjionin e dorës së djathtë, të konstatuar nga eksperti mjeko ligjor të dt.15.04.2019.

Me çka ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 të KPK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 41, 49 al. 1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76 dhe 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 të KPK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Ashtu që i vërteton **dënimin me burg prej 6 (gjashtë) muajve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepra tjera penale.

Obligohet I akuzuari që në emër të ekspertizës së mjekësisë ligjore të paguaj shumën prej 20 euro, në emër të viktimave të krimit shumën prej 30 euro, në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Sh.K për realizimin e kërkesës paurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridik civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.794-1/2019, të datës 15.05.2019 kundër të akuzuarit F.K nga fshati K.Komuna e Suharekës, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par.3 pika 3.1 lidhur me par.1 të Kodit nr. 04/L-082 Penal të Republikës së Kosovës.

Pas leximit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit Milot Krasniqi, i akuzuari ka theksuar se e ka kuptuar në tërësi akuzën dhe e ka pranuar fajësinë. Prokurori i Shtetit nuk ka patur kundërshtime lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar gjendje faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit, nga shikimi dhe leximi i raportit mjekësor me nr. të protokollit 7... të dt.29.03.2019 në emër të të lënduarës Sh.K, akt ekspertimi mjeko ligjor në bazë të dokumenteve të çështjes të dt.15.04.2019, raporti mbi gjendjen e shëndetit mendor për të akuzuarin F.K të dt.13.05.2019, fotodokumentacioni dhe shkresat tjera të lëndës.

Me rastin e marrjes të vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 73 të KP të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethana rënduese, e që si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi rrethanat personale dhe karakterin e të akuzuarit, posaçërisht gjendjen e tij mendore të cilën e ka përshkruar eksperti i forenzikës Dr.J.Z sipas të cilit i akuzuari ka çrregullim i cili karakterizohet me dëmtime afektive të labilitetit emocional, që nga adoloshenca e herëshme, ndërsa për veprën të cilën ngarkohet, aftësia e të kuptuarit dhe kontrollës dhe veprimet e veta, ka qenë e zvogëluar esencialisht, andaj gjykata i shqiptoi dënimin me kusht dhe ate dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin e verifikimit prej 1 (një) viti nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më i kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimin mbi shpenzimet gjyqësore dhe paushallin gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP-së.

Vendimi mbi kërkesën pronësoro juridike gjykata e bazoi në kuptim të nenit 463 të KPPK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË
P.nr.168/19 të dt. 07.06.2019
2019:087282

Bashk.Profesional
Feim Bytyqi

Gjyqtari
Qemal Suka

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.